



## Merr Pjesë dhe Ndrysho Komunitetin tënd!

Bëhu pjesë e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje!



*Kjo fletëpalosje në kuadër të projektit "Inovacion në Buxhetim: Pjesëmarrja e Qytetarëve si Motor i Zhvillimit Lokal" me mbështetjen nga skema e granteve "BAT Civil Society", e zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në partneritet me Faktoje dhe Center for Research and Policy Making (CRPM), mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.*



## BUXHETIMI ME Pjesëmarrje



## Çfarë është Buxhetimi me Pjesëmarrje (BP)?

Buxhetimi me Pjesëmarrje është një mekanizëm që mundëson qytetarët të marrin pjesë aktivisht në vendimmarrjen e bashkive për buxhetin publik. Kjo praktikë ndihmon qeverisjen vendore të përmirësojë transparencën, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë në planifikimin e investimeve dhe shpenzimeve



Procesi i Buxhetimit me Pjesëmarrje:

- **Rrit transparencën:** Qytetarët janë të informuar për mënyrën se si shpenzohen fondet publike.
- **Forcon përgjegjshmërinë:** Vendimet marrin vlerësim publik dhe ndërtojnë besim midis qytetarëve dhe institucioneve.
- **Përfshin grupet në nevojë:** Siguron që investimet publik të adresojnë nevojat reale të komunitetit.



## Integrimi i Perspektivës Gjinore

Ligji Nr. 68/2017 për financat e vetëqeverisjes vendore thekson rëndësinë e integrimit të perspektivës gjinore në procesin e buxhetimit. Kjo nënkupton që:

- Programet buxhetore duhet të adresojnë barazinë gjinore.
- Përfshirja e grave dhe organizatave lokale në konsultime ndihmon në formulimin e politikave që promovojnë barazinë dhe përfshirjen sociale.
- Matja e performancës: Përdorimi i treguesve të matshëm ndihmon në monitorimin e progresit drejt një qeverisjeje më të barabartë.